



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I HISTORISË

Programi: **Master**

Drejtimi: **Histori**

**Lënda: QYTETI SHQIPTAR GJATË SHEK XIX-XX**

<i>Pedagogu:</i>	Dr. Enriketa PANDELEJMONI
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS (15 javë: 2 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Viti/semestri:</i>	II/I

**Përshkrimi:** Leksioni Qyteti Shqiptar (LQSH) gjatë shek. XIX-XX do të jetë një leksion i karakterit hyrës në historinë urbane të Shqipërisë. Ky leksion do të ketë si objektiv kryesor të tij studimin e “qytetit” shqiptar. Studimi në fjalë do të shqyrtojë shkurtimisht fillimet e jetës urbane në territorin shqiptar, duke vazhduar me studimin e jetës urbane shqiptare gjatë sundimit osman, për t’u hedhur më tej në studimin e urbanitetit gjatë fillimit të shek. XX, duke u përqëndruar kryesisht në qytetet kryesore të Shqipërisë, si Durrësi, Korça Shkodra, Tirana dhe Vlora, të konsideruara qytete “shembuj” të historisë urbane shqiptare. Një tjetër aspekt përmbysës i leksionit do të jetë edhe “urbanizimi socialist” gjatë periudhës komuniste (1945-1990), ku shembuj kyç do të jenë “qytezat socialiste” d.m.th. do të synohet të studiohet fenomeni i lindjes apo krijimit të sforcuar të “qytezave” të reja në Shqipërinë Socialiste dhe jeta urbane në to. Ky cikël leksionesh do të konceptohet mbi bazën e literaturës në shqip dhe asaj në gjuhë të huaj. Çdo leksion do të paraqitet i koncentruar dhe në *hand-out* dhe *power point* në mënyrë që studentëve t’u krijohej mundësia e ndjekjes dhe e pjesëmarrjes aktive gjatë trajtimit të subjekteve përkatëse. Bashkëbisedimi dhe komunikimi lektore-studentë do të jetë primar në zhvillimin sa më efikas të leksionit.

**Temat e leksioneve:**

1. Qyteti si fenomen dhe objekt i historisë urbane dhe antropologjisë urbane
2. Studimi i Qytetit Shqiptar në bibliografinë vendase dhe botërore
3. Fillimet e urbanitetit në trojet shqiptare
4. Trashigimia urbane në Shqipërinë Otomane
5. Karakteristikat e qytetit osman dhe atij shqiptar

6. Jeta urbane në Shqipërinë Otomane
7. “Mahalla” shqiptare dhe komponentët e saj
8. Madhësia e qytetitshqiptarnëshek. XIX-XX
9. Trashigimia urbane otomane në Shqipërinë e Pavarur
10. Tirana kryeqyteti i ri - “Urbanizimi” i Tiranës prej 1920
11. “Europianizimi” vs. “otomanizimi” i jetës urbane shqiptare 1900-1944
12. Shqipëria komuniste dhe “lindja” e qytetit të ri
13. Jeta urbane nësocializëm
14. Parafabrikatet – betonizimidheindoktrinimijetesësqytetase
15. Trashigimia urbane socialiste në fund të viteve ’80-të

#### **Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	10% e notës
- Testi II:në javën e 10-të	10% e notës
- Detyra e kursit ose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

#### **Literatura e detyrueshme për studentin:**

##### LEKSIONET NË AUDITOR

- Bushati, Hamdi. 1998. Shkodra dhe Motet. Vëll. I-II. Shkodër.
- Duka, Valentina. 1997. Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924. Tiranë.
- Goffman, Daniel. 2002. The Ottoman Empire and Early Modern Europe. Cambridge.
- Miho, Koço. 2003. Shqipëria. Vështrimurbanistik. Tiranë.
- Riza, Emin. 2004. Qyteti muze i Gjirokastrës. Tiranë.
- Shkodra, Zija. 1984. Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare. Tiranë.

MIRATOI

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Asoc.dr. Eva Tafili

Tiranë, 2016